

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Fatime Dermaku, me Sahadete Gashi, procesmbajtëse, në çështjen penale, kundër të pandehurit R. S. Z. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.I.nr.136/15 të datës 02.03.2016, të cilën e përfaqësonte prokurori i Shtetit Naim Abazi, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 05.10.2017, mori dhe publikisht shpalli në njëjtën ditë këtë

AKTGJYKIM

I pandehuri R. Z., nga babai S. dhe nëna B. e vajzeris B. i lindur më *data e lindjes...*, nga V. ku edhe tani jeton në rrugën “...” V., me numër personal *numri personal...*, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i arsimuar me profesion Ekonimst, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse në kohë të papërcaktuar e gjer me datën 09.12.2014, rreth orës 10:00 ne P., në rrugën”... ”saktësisht përball hyrjes së ATK-së i pandehuri duke lëvizur me automjetin e tipit “Nisan Terrano” ngjyrë e kaltër me targa regjistrimi *numri i targave...*, nga pakujdesia duke mendur se deri te aksidenti nuk do te vije ,ka rrezikuar komunikacionin dhe ka vënë në rrezik jetën dhe trupin e njerëzve ,ashtu qe ka vepruar ne kundërshtim me nenin 150.3 te LSKRR-së duke mos e përshtatur mënyrën e lëvizjes kushteve dhe rrethanave te krijuara në rruge, ku i njëjti nuk i kushton kujdesin e duhur pjesëmarrësve tjerë ne komunikacion, e me këtë rast këmbësorin të dëmtuarin G. J. e godet me anën e majtë të automjetit i cili në momentin kritik ka qenë afër automjetit i cili fillimisht ka qenë i ndaluar dhe me pasi ka filluar te lëviz ,me ç’rast i dëmtuari pëson lëndime te rënda trupore ,si thyrje vizore e kockës së kokës në regjionin tëmthor të anës së majte dhe gjakderdhje nga veshi i majte.

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së

Andaj, gjyqtarja e vetme gjykuese, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 51,52, 62 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 7, 69, 73,74,75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 248 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,¹ të pandehurit R. Z., i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

¹ Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

- Ashtu që të pandehurit R. Z., i caktohet dënimi me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë, nëse në afat prej 1(një) viti, nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.
- I dëmtuari G. J. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil
- Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë Euro (20 €), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 02.03.2016, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.136/15 të, ndaj të pandehurit R. Z. nga V. , për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së

Pas pranimit të aktakuzës, gjyqtarja e vetme gjykuese, e ka caktuar shqyrtimin gjyqësor për datën 05.10.2017, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri R. Z., nga pakujdesia e ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 378 paragrafi 1 të KPK, është parashikuar se forma themelore e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik është: “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton diku lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet..” Ndërsa paragrafi 8 i nenit 378 ka përcaktuar: “Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.” Paragrafi 6 i nenit 378 parasheh: “Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”. Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, gjyqtarja e vetme gjykuese, e ka shpallur fajtor të pandehurin R. Z., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, ngase në veprimet e të njëjtit konsumohen të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vetë, i njëjti me datën 09.12.2014, nga pakujdesia ka arritur deri te aksidenti me c’rast ka rrezikua jetën e këmbësorit G. J., i cilit i ka shkaktuar lëndime te rënda trupore dhe me ketë shprehë keqardhje për rastin, kërkon falje dhe deklaron se është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe premtion gjykatës se ne të ardhmen do te tregohet me i kujdesshem për te mos kryer përsëri ndonjë vepër penale se qëllimisht as që bëhet fjalë.

5. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka vendosur që të pandehurin R. Z., t’u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur meqenëse u vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë sjelljet e mira të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor; pranimin e fajësisë; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës gjyqtarja e vetme gjykuese, ja fali besimin, se i njëjti është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale. Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg në kohëzgjatje prej 1 viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit dhe të ardhurat e tij meqenëse siç e theksuam më lartë ka pesë fëmijë dhe është mbajtës i familjes, ndërsa, gjyqtarja e vetme gjykuese, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë çështje penale.

7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarja e vetme gjykuese, dënimi me dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale ndaj të pandehurit R. Z., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Udhëzimi I të dëmtuarit në kontest juridiko-civil

Gjykata konform nenit 458 e 463 të KPPRK-se vendosi që të udhëzoi të dëmtuarin në kontest civil, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike të të pandehurit.

9.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjyqtarja e vetme gjykuese, duke u bazuar nënin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të akuzuarin t'a detyrojë për ta paguar paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1310/2016
Më 13.10.2017

Zyrtarja ligjore,
Edona Grajçevci

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Fatime Dërmaku

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.